

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **21432700-23-14367-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Krijimi i sitemit per menaxhim e aktiviteteve te AME dhe NJPZSH**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Cactus Sh.a. & BNT Electronics

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Bashkim Fehmiu 3 BC2/11 V1-Lo1-S

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383(0) 38 600 488

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

z. Armend Malazogu-Drejtor Menaxhues

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@cactus.com

(Adresa elektronike)

30.04.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë – 17.04.2024
- Dosja e tenderit korrigjuar – 08.08.2024
- Procesverbali i hapjes – 23.08.2024
- Njoftim mbi vendimin e AK-së – 26.09.2024
- Njoftim mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim – 02.10.2024
- Ankesa ne OSHP – 14.10.2024
- Vendimi I OSHP-së -11.03.2025
- Njoftim mbi vendimin e AK-së – Rivleresim – 17.04.2025
- Kërkesa për rishqyrtim – 22.04.2025
- Vendimi për refuzim i kërkesës për rishqyrtim nga AK- 23.04.2025
- Parashtrimi i ankesës OSHP- 30.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja ne mënyre elektronike e ofertave është bere me datën 23.08.2024 Nuk kemi marre pjese në hapje të ofertave

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Vendimi i autoritetit kontraktues ne raport me kërkesën për rishqyrtim është refuzuar. Te bashkangjitur ne kete ankesë gjeni vendimin e ndërmarr nga Autoriteti kontraktues dhe kërkesën per rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 – Qëllimi

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 56.3 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 105 – Kompetencat e OSHP-së

Regullorja per prokurim publik nr. 001/2022 (versioni i konsoliduar) neni 97, shkeljet e renda pika (h)

Mos respektim i vendimit te OSHP-së te nxjerrë me dt. 11.03.2025

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar anëtarë të OSHP-së,

Përmes kësaj deklarate, dëshirojmë të ofrojmë një përmbledhje të shkeljeve të bëra nga ana e Autoritetit Kontraktues në rastin konkret.

Pika e parë e eliminimit dhe pretendimi ankimor

Duke mos u përsëritur në sqarimet dhe dokumentacionin shtjellues të paraqitur fillimisht pranë Autoritetit Kontraktues, të cilat janë shqyrtuar nga ekspertët profesionalë dhe janë reflektuar në mënyrë të qartë edhe në vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), si operator ekonomik “**Cactus**” SH.A konsiderojmë se, përkundër të gjitha konstatimeve dhe rekomandimeve të qarta ligjore dhe profesionale, Autoritet Kontraktues **ka vepruar sërish në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP)** dhe aktet nënligjore përkatëse, duke na eliminuar padrejtësisht nga procedura e mëtejme e prokurimit.

Ky veprim, përveçse përbën **shkelje procedurale**, cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë **parimet themelore të prokurimit publik**, si transparenca, barazia dhe konkurrenca e ndershme, si dhe **nuk respekton vendimin e OSHP-së**, i cili është **përfundimtar ne procedur administrative dhe i detyrueshëm për palët**, sipas nenit 105 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të mëposhtme:

- **Neni 1** – *Qëllimi i ligjit*, i cili thekson rëndësinë e ligjshmërisë, transparencës dhe drejtësisë në procedurat e prokurimit publik;
- **Neni 6** – *Ekonomiciteti dhe efikasiteti*, që kërkon përdorim racional dhe të përgjegjshëm të fondeve publike;
- **Neni 7** – *Barazia në trajtim dhe ndalimi i diskriminimit të operatorëve ekonomikë*, që garanton konkurrencë të ndershme për të gjithë pjesëmarrësit;
- **Neni 56.3** – Lidhur me përzgjedhjen dhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë, ku përcaktohet qartë momenti dhe mënyra e vlerësimit të kriterëve;
- **Neni 59** – Që rregullon procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, i cili duhet të jetë objektiv dhe në përputhje me dokumentacionin e tenderit;
- **Neni 105** – I cili e bën të qartë se vendimet e OSHP-së janë përfundimtare dhe të detyrueshme për autoritetet kontraktuese. Konkretisht, pika 2.16 përcakton se në rastet e përsëritura me pretendime të njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta me ato të shqyrtuara më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet ta trajtojë çështjen si të përfunduar (“*res judicata*”).

Gjithashtu, janë shkelur dispozitat e:

- **Rregullores për prokurim publik nr. 001/2022 (versioni i konsoliduar), neni 97,** konkretisht pika (h), e cila klasifikon si shkelje të rëndë moszbatimin e vendimeve të OSHP-së nga ana e autoritetit kontraktues.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së – Vendimi nr. 2024/0976, datë 11.03.2025

Ashtu siq është specifikuar në vendim, Paneli Shqyrtues i OSHP-së, duke u bazuar në **raportin e superekspertizës**, ka vendosur që ankesa jonë të aprovohet si **pjesërisht e bazuar**, dhe ka adresuar në mënyrë eksplicite, duke vendosur me vendim qeshtjen kryesore për qka jemi eliminuar nga autoriteti kontraktues në rastin konkret, kjo është pasqyruar në vendimin e OSHP-së, faqe 19, si me poshtë:

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Cactus” SH.A në ankesën Nr. 2024/0976

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në konstatimet dhe rekomandimet në raportin e superekspertizës, ka gjetur se ankesa duke të aprovohet si pjesërisht e bazuar, konform rekomandimeve të ekspertëve shqyrtues teknik dhe profesional. Lidhur me garancionin e produkteve, PSH konform nenit 56.3 të LPP, e mbështet ekspertin profesional i cili ka deklaruar se Autoritetit Kontraktues në kërkesat kualifikuese në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk e ka përcaktuar garancionin si kriter kualifikues. Garancioni është përmendur vetëm në specifikimet teknike, që do të thotë se duhet të sigurohet me dorëzimin e produktit, jo në fazën e ofertës.

Referimi në raportin e ekspertizës nga ana e Autoritetit Kontraktues, në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, **përpiqet të paraqitet si përfundimtar**, duke **anashkaluar plotësisht vendimin e OSHP-së**. Kjo përbën shmangie të hapur nga dispozitat ligjore në fuqi, të cilat theksojnë se **raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin Shqyrtues**, por vetëm një ndër elementët që mund të merren në konsideratë gjatë shqyrtimit të çështjes.

Çdo raport ekspertize vlerësohet apo analizohet në **kontekstin e përgjithshëm të dokumentacionit të lëndës, fakteve të prezantuara dhe provave relevante**, gjithmonë duke marrë parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën procedurale dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Si i tillë, vendimi për t’u mbështetur apo jo në ndonjë raport ekspertize apo në rekomandimet e tij **i takon ekskluzivisht gjyqimit të pavarur dhe profesional të Panelit Shqyrtues**, në përputhje me përgjegjësitë që i janë ngarkuar sipas **nenit 98, 99 dhe nenit 105 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)**.

1. Garancioni i produkteve

Ashtu siq u potencua edhe me lartë me vendimin përkatës, OSHP ka konstatuar se garancioni për produktet **nuk është përcaktuar si kriter kualifikues** në dosjen e tenderit dhe as në njoftimin për kontratë. Ky element është përmendur vetëm në **specifikimet teknike**, çka sipas nenit 56.3 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) **nënkupton se ai duhet të ofrohet në momentin e dorëzimit të produktit**, e jo në fazën e ofertimit.

Për rrjedhojë, përdorimi i mungesës së garancionit në dokumentacionin e ofertës sonë si **arsyetim për eliminim është i pabazuar ligjërisht dhe bie ndesh me vendimin e OSHP-së**.

2. Mungesa e mjeteve financiare

Pretendimi i Autoritetit Kontraktues për mungesën e mjeteve financiare është gjithashtu i pabazuar. OSHP e ka trajtuar këtë çështje dhe ka konstatuar se **mungesa e fondeve nuk mund të përbëjë arsye të ligjshme për eliminim të operatorëve ekonomikë apo anulim të procedurës së prokurimit.**

Për më tepër, sigurimi i fondeve është **obligim ligjor dhe procedural i vetë Autoritetit Kontraktues** si organizatë buxhetore. Sipas rregullave në fuqi, fondet duhet të jenë të aprovuara **para nisjes së procedurës së prokurimit**, dhe jo pas dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë. Të konkludohet në fund të procesit se fondet nuk janë miratuar është **kundërligjore, joprofesionale dhe bie ndesh me praktikat standarde të menaxhimit të buxhetit public dhe me vet zhvillimin e procedurave tenderuese.**

Autoriteti Kontraktues, përveç obligimit për të siguruar mjetet paraprakisht, ka në dispozicion edhe mekanizma ligjorë si:

- **ndryshimi i destinacionit të mjeteve** brenda kuadrit buxhetor, apo
- **kërkesa për rishikim të buxhetit**, në raste të veçanta.

Në të gjitha rastet, **zgjidhja e kësaj çështjeje i takon ekskluzivisht Autoritetit Kontraktues**, dhe nuk mund të përdoret si bazë për penalizimin apo eliminimin e operatorëve ekonomikë që kanë dorëzuar ofertat në përputhje me kërkesat e tenderit

Dëshmi shtesë mbi garancionin:

Pavarësisht që vendimi i OSHP-së ka konstatuar se garancioni kërkohet të ofrohet në momentin e dorëzimit të produktit, jo në fazën e ofertimit, po e paraqesim sërish si **dëshmi të mjaftueshme** dokumentin përkatës ku garancioni është qartësisht i përfshirë. Pjesa e **hijezuar** në dokumentin bashkëngjitur tregon për specifikimin e garancionit të produkteve të ofruara nga kompania jonë.

Part Number	Product Description
71H61AV	HP IDS UMA i7-1355U RTKUSBC 450 G10BNBPC
72F29AV	FreeDOS
4SS11AV	OS Localization
726V7AV	DM 5MP USB2 IR WFOV Intgrtd Cam
726U6AV	15.6 AG FHD UWVA LED250f5MPIRbntLCDPanel
726W2AV	16GB (1x16GB) DDR4 3200
71K04AV	512GB PCIe NVMe Value SSD
726U2AV	PKS ALU U15/Pentium ID
727Q1AV	Intel AX211 Wi-Fi 6E 160MHz +BT 5.3 WLAN
72F56AV	No WWAN
71K01AV	SEC Fingerprint Sensor
727N7AV	RH Long Life 51Whr FstCrg 3 cell Batt
727N2AV	65 Watt nPFC USB-C AC Adapter
72M11AV	Clickpad w/num kypd SR
72F90AV	Country Localization

68V61AV	C5 1.0m stkr CNVTL Power Cord
72G12AV	1/1/0 Warranty
4N733AV	HP Tamper Lock
1D4F5AV	DIB HP Prelude Pro 15.6 Top Load
726U5AV	Standard Packaging
3AH75AV	EU RED Pictogram Label
6E6V5AV	Core i7 sz3 G13 Label
AY129AV	HP Chassis Tag Service Variant 2
766U6AV	HP Chassis Tagging SN+HBMA+WLAN+PKID SVC
UK707E	HP 3y Pickup and Return NB HW Supp
ZD021A	HP standard delivery(Door/Dock) notebook
64W34AA	HP P24h G5 FHD Monitor
7E953AV	HP ProTWR 400 G9 R 260W RCTO PCI BUDTPC
4N8D0AV	FreeDOS
4YH35AV	OS Localization
7E964AV	Intel Core i5-13500 2.50G 14C 65W CPU
4J376AV	16GB (1x16GB) DDR4 3200 NECC
4J391AV	1TB 2280 PCIe NVMe Value SSD
4J342AV	HP 125 BLK WD KBD
4J367AV	HP 125 BLK WRD Mouse
603U0AV	Realtek 8852BE Wi-Fi6 +BT 5.3 WLAN
56H82AV	No Intel vPro
4S347AV	No Front Opt Port
4N8C5AV	No Included ODD
4U7P9AV	HP 400 TWR Country Kit
630T3AV	C13 1.83m stkr CNVTL Power Cord
4N8G7AV	1/1/1 TWR Warranty
4J358AV	Single Unit (TWR) Packaging
5B343AV	SATA Power cable w/RF
641B8AV	Elite Tower Non ODD Gskt
6E670AV	1/1/1 TWR LBL
7E969AV	Intel Core i5 Raptor Lake Label
AY129AV	HP Chassis Tag Service Variant 2
YT925AV	Chassis Tag SN+MAC1+MAC2
U10N3E	HP 3y Next Bus Day Onsite DT HW Supp
ZD011A	HP standard delivery (Door/Dock) desktop

Duke marrë parasysh të gjitha sa u theksuan më sipër, si dhe faktin që vendimi i OSHP-së është përfundimtar dhe i detyrueshëm për Autoritetin Kontraktues, kërkojmë me insistim që OSHP-ja të ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore për të garantuar zbatimin e këtij vendimi.

Dispozitat e shkelura nga ana e autoritetit kontraktues

Neni 1 - Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të

tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1 i cili thotë se:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, pika 2 dhe 4 e këtij neni

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm, qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen, konkretisht pika 2 dhe 4 i cili thotë se:

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) **përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë,** ose (ii) **përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit;** me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Neni 105 - Kompetencat e OSHP-së, me theks te veqanet pika 2.16 e ketij neni, e cila thotë se:

2.16. Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe sqarimet e ofruara më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **OE: Cactus Sh.a. & BNT Electronics**

ANULOHET njoftimi dhe vendimi i AK-së dhe lënda te kthehet në **RIVLERËSIM**

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi I ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktoar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës, përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim. si dhe ankese. Këto shpenzime përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- **Shpenzimet për përgatitjen e ofertës:** Këto përfshijnë kostot për hartimin e dokumenteve, analiza të nevojshme për përgatitjen e ofertës, konsulta ligjore dhe shpenzimet administrative që kanë ndodhur gjatë periudhës përgatitore.
- **Shpenzimet për përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim dhe ankese:** Këto përfshijnë kostot për hartimin e kërkesës, mbështetjen ligjore dhe administratën e

nevojshme për paraqitjen e ankesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.

- **Fitimet e pritura:** Në përputhje me ofertën e bërë, ne kishim parashikuar fitime të caktuara nëse do të shpallej fituesi i procedurës së prokurimit. Eliminimi i papranueshëm nga procedura ka rezultuar në humbjen e mundësisë për të realizuar këto fitime.

Për këto arsye, kërkojmë që në përfundim të shqyrtimit të ankesës sonë, të merret parasysh dhe kompensimi i shpenzimeve të bëra, si dhe humbja e fitimeve të pritura si pasojë e shkeljeve të bëra nga Autoriteti Kontraktues.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Vendimi i AK mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim,*
- g) Vendimi paraprak i OSHP- së,*
- h) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- i) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*